



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernora Governor's Office	
E Dërguar: Pretido: Send to:	DITP
Date: Telut: No:	26.09.2024
Nr: Br: No:	488-D-24

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1. 17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010) të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 03 prill 2017), nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.12/03 maj 2013), Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2024, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR STANDARDIN E QR KODIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat dhe kërkesat teknike për funksionimin e strukturës së QR kodit në Republikën e Kosovës. Ky specifikim i QR kodit i mbulon pagesat në shitje me pakicë dhe pagesat e faturave.
2. Implementimi i standardit të QR kodit do të ndihmojë në promovimin e përdorimit më të gjërë të pajisjeve telefonike për pagesa, nëpërmjet ndërveprimit dhe ofrimit të një përvoje të qëndrueshme për përdoruesit dhe konsumatorët.
3. Ky udhëzim do të zbatohet për transaksionet e pagesave që bëhen përmes QR kodit. Të gjithë ofruesit e shërbimit të pagesave që ofrojnë shërbime me QR kod në Republikën e Kosovës, janë subjekt i dispozitave të këtij udhëzimi.

Neni 2

Përkufizimet

1. "BQK" - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;

2. “Llogaria” Identifikuesi që definojnë në mënyrë unike klientin, por nuk përfshijnë identifikuesin e institucionit financiar në të cilin mbahet llogaria;
3. “Ofruesi i shërbimeve të pagesave për shërbime të llogarisë (ang. Account Servicing Payment Service Provider -ASPSP)” Çdo person fizik ose juridik të licencuar, regjistruar ose autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si ofrues i shërbimit të pagesave (PSP) që ofron dhe mban një llogari pagese për një dërgues ose pranues të pagesës;
4. “Numri bazik i llogarisë bankare (ang. Basic Bank Account number - BBAN)” Identifikuesi që e dallon në mënyrë unike një llogari individuale në një institucion financiar specifik, në një juridiksion të caktuar. BBAN përfshijnë identifikuesin bankar të institucionit financiar që i shërben asaj llogarie;
5. “Agjentët Cash In Cash-out (ang. Cash-in Cash-out Agents-CICO Agent)” zakonisht veprojnë në zona ku bankat tradicionale nuk janë të pranishme. Disa nga shërbimet që ofrohen përmes këtij shërbimi financiar përfshijnë depozita dhe tërheqje të parave të gatshme, pagesa faturash dhe transfera parash në pajisje telefonike;
6. “Konsumator” Personi që blen/përdor mallrat dhe/ose shërbimet;
7. “Të dhënat e paraqitura nga konsumatori/ QR kodit” Të dhënat e ofruara nga konsumatori në pika e ndërveprimit (POI) të tregtarit. Gjithashtu referohen si QR kodit i paraqitur nga pagesi;
8. “Transferi i kreditit” Urdhërpagesë e dhënë nga një inicues (pages/debitor) për pjesëmarrësin urdhëruar që kërkon ekzekutimin e një transaksioni të kreditit, që përbëhet nga informacioni i nevojshëm për ekzekutimin e transaksionit të kreditit dhe është iniciuar në mënyrë direkte ose indirekte;
9. “Klienti” Një pages ose një i paguar që mund të jetë ose një konsumator ose një biznes (tregtar);
10. “Kuletat digjitale” Një shërbim i lidhur nëpërmjet një pajisjeje të konsumatorit, që i lejon mbajtësit të kuletës të kyçet, menaxhojë dhe përdorë në mënyrë të sigurt një sërë shërbimesh/aplikacionesh duke përfshirë pagesat, identifikimin e klientëve dhe shërbimet jo-financiare (p.sh., shërbimet si programet e besnikërisë, kuponat, etj.). Një kuletë digjitale nganjëherë referohet edhe si një kuletë elektronike (e-wallet);
11. “Numri i llogarisë bankare ndërkombëtare (ang. International Bank Account Number -IBAN)” Një standard ndërkombëtar i identifikimit të llogarive bankare përtej kufijve kombëtarë për të lehtësuar komunikimin dhe përpunimin e transaksioneve ndërkombëtare që përfshijnë kodin e vendit, dy (2) shifra kontrolli dhe një BBAN;
12. “Sistemi i pagesave Instant/Pagesave të shpejta (ang. Instant Payment System / Fast Payment System)” Zgjidhjet elektronike të pagesave me pakicë që janë në dispozicion 24/7/365 dhe rezultojnë në kliringun e menjëhershëm ose afërsisht të menjëhershëm ndërbankar të transaksionit dhe kreditimin e llogarisë së përfituesit me konfirmim të pagesi (brenda sekondave nga fillimi i pagesës);
13. “Kycja e transaksionit (ang. Lock Transaction)” Mesazhet e kushtëzuara të kyçjes së transaksionit dërgohen ndërmjet ofruesit të shërbimit MCT të konsumatorit dhe ofruesit të shërbimit MCT të Tregtarit nëpërmjet HUB për të parandaluar konsumatorët e ndryshëm nga ofruesit e shërbimeve MCT të ndryshëm që të paguajnë për të njëjtin transaksion pas

autentikimit të fortë të klientit. Funkzioni i kyçjes së transaksionit kërkohet në rastet kur QR kodi qëndron aktiv për një periudhë kohore dhe mund të mundësojë skanime të shumta dhe pagesa të shumta. Nevoja e kyçjes së transaksionit duhet të specifikohet;

Nëse dy konsumator e kryejnë autentifikimin e fortë të konsumatorit (ang. strong customer authentication SCA), transaksioni kyçet për konsumatorin me autentifikimin e fortë të konsumatorit të suksesshëm për të cilin ofruesi i shërbimeve MSCT i tregtarit e pranon funksionin e kyçjes së transaksionit së pari;

14. “Tregtari” Një përfitues brenda një skeme pagese për pagesën e mallrave ose shërbimeve të blera nga konsumatori. Një tregtar mund të quhet edhe i paguari dhe përfshin individë privatë, biznese, korporata, institucione qeveritare, etj;
15. “Të dhënat e QR kodit të prezentuar nga tregtari” Të dhënat e ofruara nga pika e ndërveprimit (POI) e tregtarit për konsumatorin. Gjithashtu mund të referohemi si QR kodi i paraqitur nga i paguari;
16. “MCT” Transferi i kreditit i nisur nga pajisja telefonike (ang. Mobile Initiated Credit Transfer);
17. “Ofruesi i shërbimeve MCT (ang. MCT Service Provider)” Një ofrues i shërbimeve që ofron ose lehtëson një shërbim MCT për një pagues ose të paguar në një transaksion pagese të shpejtë. Kjo mund të përfshijë ofrimin e një aplikacioni të dedikuar MCT për shkarkim në pajisjen telefonike të klientit ose ofrimin e softuerit të dedikuar për tregtarin në pikën e ndërveprimit (POI) (tregtarët fizik ose virtual). Si shembull, një ofrues shërbimi MCT mund të jetë një PSP (p.sh., një ASPSP ose ndonjë palë që vepron si PISP nën PSD2) ose një ofrues shërbimi teknik që mbështet një PSP;
18. “QR Kodi” Kodi i përgjigjes së shpejtë i cili është një lloj barkodi me matricë dy-dimensionale;
19. “Metoda e ngarkesës së të dhënave në QR kodit” I referohet formatit të përdorur për të dhëna e ngarkuara në QR kod, dhe mund të jetë token, proxy ose tekst ;
20. “QR Kodi i paraqitur nga i paguari (ang. Payee-presented data/QR Code)” Të dhënat e ofruara nga pika e ndërveprimit të tregtarit për konsumatorin, i referuar gjithashtu si QR kodi i paraqitur nga tregtari;
21. “QR Kodi i paraqitur nga paguesi (ang. Payer-presented data/QR Code)” Të dhënat e ofruara nga konsumatori në pika e ndërveprimit të tregtarit, gjithashtu i referuar si QR kodi i paraqitur nga konsumatori;
22. “Skema e pagesës (ang. Payment Scheme/ Scheme)” Skema është një grumbull i rregullave, praktikave, procedurave, standardeve apo marrëveshjeve, të përcaktuara nga Operatori i Sistemit të Pagesave (BQK), të cilave pjesëmarrësit duhet t'u përmbahen për të marrë pjesë në Sistemin e Pagesave (p.sh., FPS) ;
23. “I paguari (ang. Payee)” Një person fizik ose juridik i cili është marrësi/përfituesi i synuar i fondeve (shembuj përfshijnë tregtar, biznes dhe një individ);
24. “Paguesi (ang. Payer)” Një person fizik ose juridik që mban një llogari pagese dhe lejon një urdhërpagesë nga ajo llogari pagese, ose, kur nuk ka llogari pagese, një person fizik ose juridik që jep urdhër për fillimin e një pagese;

25. "Ngarkesa e pagesës (ang. Payload/QR Payload)" Të gjitha të dhënat e përfshira në QR kod që lidhen me një transaksion;
26. "Lëshuesi i ngarkesës së pagesës (ang. QR Payload Issuer)" Subjekti përgjegjës për lëshimin e ngarkesës së pagesës. Ky mund të jetë ofruesi i shërbimit MSCT ose një subjekt tjetër (p.sh., një blerës), që vepron nën këtë ofrues të shërbimit MSCT;
27. "Pika e ndërveprimit (ang. Point of Interaction - POI)" Pika fillestare në mjedisin e tregtarit (p.sh. POS, makina shitëse, faqja e pagesave në faqen e internetit të tregtarit, QR kodi në një poster, etj.) ku të dhënat shkëmbehen me një pajisje konsumatori (p.sh. pajisje telefonike) ose ku të dhënat e konsumatorit futen për të iniciuar një transfer të menjëhershëm kredie;
28. "PSD2" Është një direktivë Evropiane për shërbimet e pagesave. Qëllimi i kësaj direktive është që t'i bëjë pagesat më të sigurta në Evropë, të nxisë inovacionin dhe të ndihmojë shërbimet bankare të përshtaten me teknologjitë e reja;
29. "Proksi (ang. Proxy)" Është një identifikues i lehtë për të mbajtur mend llogarinë e klientit që u mundëson klientëve të bëjnë pagesa duke përdorur këtë identifikues në vend të një numri llogarie. Nganjëherë referohet si një "alias" dhe përdoret për të tërhequr një identifikues llogarie pagese të lidhur me proksin (p.sh., numrin e telefonit, adresën e postës elektronike, etj.). Si shembull, një proksi mund të përdoret për të zëvendësuar një IBAN dhe më pas përdoret për të nxjerrë detajet e llogarisë përkatëse;
30. "Tokenizimi" Procesi i zëvendësimit të llogarisë së pagesës, të dhënave të identifikimit përdoruesit të shërbimit të pagesave (PSU) ose të dhënat tjera të ndërlidhura me transaksionin me një vlerë zëvendësuese, i referuar si një token;
31. "Token" Tokenët mund të marrin një sërë formatesh në të gjithë industrinë e pagesave. Ato në përgjithësi i referohen një vlere zëvendësuese për llogarinë e pagesës (p.sh. IBAN), të dhënat e identifikimit të konsumatorit (p.sh. ID-ja e klientit) ose të dhënat e lidhura me transaksionin. Tokenët e pagesave nuk duhet të kenë të njëjtën vlerë ose të bien ndesh me të dhënat e llogarisë reale të pagesës. Nëse në token përfshihen të dhënat e paraqitura nga marrësi i pagesës, ai mund të referohet si një token tregtar; nëse në token përfshihen të dhënat e paraqitura nga konsumatori, ai mund të referohet si një token konsumatori.

Neni 3

Roli dhe funksioni i QR kodit

1. QR kodi është një lloj barkodi dy-dimensional i cili lejon kodimin e të dhënave në koordinata horizontale dhe vertikale. QR kodi lexohet nga pajisjet dhe mund të lexohen nga kamerat e telefonave të mençur. Këto kode janë të kuptueshme për përdoruesit dhe përdoren në shumë sektorë, duke pasur rritje edhe në sektorin e pagesave. QR kodi bazohet në teknologjinë e afërsisë (ang. proximity technology) për shkëmbimin e të dhënave mes dy palëve, pra në mes konsumatorit dhe tregtarit për të mundësuar iniciimin e pagesave.
2. QR kodi do të mbështesë çasje në instrumentet dhe kanalet inovative digjitale, duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve financiare digjitale dhe duke zhvilluar edhe juridiksionin për përfshirje financiare, duke plotësuar nevojat e individëve, bizneseve, sektorit financiar dhe duke ndjekur hapat e zhvillimit ekonomik dhe financiar regional dhe ndërkombëtar.

3. QR kodi sjellë një mori benefitesh si për konsumatorët ashtu edhe për tregtarët, duke ofruar lehtësi në përdorim, siguri më të madhe, efektivitet të kostos për tregtarët dhe blerësit.
4. Specifikimi i QR kodit do të promovojë ndërveprueshmërinë, duke lehtësuar pagesat midis skemave të ndryshme të pagesave, kuletave digjitale dhe bankave, duke inkurajuar tregtarët të adaptojnë QR kodin si një metodë pagese.
5. QR kodi ofron një përvojë shtesë të vlefshme për përdoruesit për iniciimin dhe pranimin e pagesave mes konsumatorëve dhe tregtarëve. Standardi i QR kodit do të sjellë përfitime praktike për ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorët në një sërë mënyrash, duke përfshirë:

5.1.Thjeshtimin e procesit të iniciimit dhe kryerjes së transaksioneve të pagesave.

5.2.Përdorimi i QR kodit pritet të rrisë sigurinë dhe mbrojtjen e transaksioneve të pagesave duke i nxjerrë të dhënat direkt nga kodi, gjë që shmangë gabimet e pagesës.

5.3.Përdorimi i QR kodit do të unifikojë mënyrat e pagesës në të gjithë industrinë, në mënyrë që konsumatorët të mos kenë nevojë të kalojnë procesin e memorizimit të numrave të ndryshëm të pagesave të tregtarëve sa herë që bëjnë blerje.

Neni 4 Standardi i QR kodit të përdorur

1. Ky standard i QR kodit udhëzon se si duhet të paraqiten të dhënat nga pjesëmarrësit, duke përfshirë se cilat fusha janë të detyrueshme/opsionale. Aplikacionet e skanimit nga klientët duhet t'i interpretojnë të dhënat në përputhje të këtij standardi.
2. BQK-ja ka zgjedhur standardin e EPC-së për të zhvilluar standardin shtetëror të QR kodit për të mundësuar përdorimin e QR kodit në rastet të parapara nga BQK-ja
3. Standardi i QR kodit të EPC përfshinë:
 - 3.1. EPC024-22 Verzioni 2.0 “Standardizimi i QR kodit për transferet e kreditit SEPA instant të iniciuara nga telefonat e mençur”
 - 3.2. EPC212-21 Verzioni 1.1 “Standardizimi dhe qeverisja e QR kodeve për FPS në pikat e ndërveprimit (POI)”
4. Përdorimi i standardit të QR kodit do ta bëjë më të lehtë ndërveprimin me skemat e tjera evropiane të pagesave në të ardhmen.
5. Udhëzimet për strukturën e QR kodit dhe modelin e zbatimit përshkruhen në Shtojcën 1 “Specifikat e EPC për QR kodin për Pagesa”.

Neni 5 Parimet për pajisje me QR kodin

1. Parimet e mëposhtme zbatohen për një institucion financiar/institucion qeveritar që synon t'ju ofron konsumatorëve produkte dhe shërbime duke përdorur QR kodin:

- 1.1. Të gjitha produktet dhe shërbimet e bazuara në QR kod duhet të jenë në përputhje me standardin e përcaktuar të QR kodit, duke respektuar rregullat e skemës në të cilën përdoren këto produkte dhe shërbime;
- 1.2. Për të reduktuar rrezikun e mashtrimit dhe vjedhjes së kredencialeve të Paguesit ose të Paguarit, lejohet vetëm modeli i i pagesës me transferim krediti (ang. credit push) dhe modeli kërkesës për të paguar (ang. request to pay), ku paguesi udhëzon institucionin e tij financiar të debitorit dhe të kreditorit të paguarin;
- 1.3. Duhet të zbatohen masat e duhura të sigurisë për të garantuar sigurinë dhe privatësinë e të dhënave të klientit, duke iu referuar Nenit 13 të këtij udhëzimi;
2. Në rastet kur përdoret modeli i paraqitjes së QR kodit nga konsumatori (ang. Consumer-presented), në përputhje me kërkesat EPC, modeli i propozuar përdor tokenizimin për të shmangur ekspozimin e detajeve të llogarisë së konsumatorit;
3. Çdo produkt dhe shërbimit i ri i bazuar në QR kod, duhet të jetë ndërveprues dhe institucioni financiar/operatori i shërbimit duhet t'i përmbahet procesit të certifikimit të përcaktuar nga BQK-ja. Institucioni financiar do të duhet të marrë miratimin e BQK-së për të zbatuar çdo risi të re dhe duhet të dëshmojë ndërveprueshmërinë e inovacionit.
4. Në rast mosmarrëveshjes, do të zbatohen rregullat e skemës siç përshkruhet nga skema në të cilën QR kodi është përdorur për të iniciuar një pagesë ose një kërkesë për pagesë;

Neni 6

Modelet e shkëmbimit të QR kodit

1. Ekzistojnë dy modele të shkëmbimit të QR kodit:
 - 1.1. Modeli “paraqitja e QR kodit nga i paguari” (ang. Payee-presented), ndryshe e njohur edhe si paraqitja QR kodit nga tregtari (ang. Merchant-presented) ku të dhënat e QR kodit e identifikojnë tregtarin dhe informatat e transaksionit
 - 1.2. Modeli “paraqitja e QR kodit nga Paguesi” (ang. Payer-presented), ndryshe e njohur edhe si paraqitja e të dhënave nga konsumatorit, ku të dhënat e QR kodit e identifikojnë konsumatorin.
2. Paraqitja e QR kodit nga i paguari(ang. Payee-presented) i mundëson tregtarit që të paraqesë një kërkesë për pagesë te Paguesi (ang. payer), i cili pastaj mund ta verifikojë informatën e transaksionit dhe ta autorizojë ose ta anulojë kërkesën për pagesë. Ky model i mbështetë disa tipe të pagesave, siç janë pagesat e faturave, pagesat online dhe pagesat në POS. Ky ndërveprim kërkon që konsumatori të posedojë një telefon të mençur me një aplikacion i cili i lejon atij të skanojë QR kodin nga i paguari për të iniciuar një transaksion pagese. PAGESA MË PAS PROCESOHEM nga aplikacioni i konsumatorit në pajisjen e tij dhe i drejtohet institucionit financiar të tregtarit dhe të dyja palët zakonisht njoftohen për përfundimin e transaksionit.

3. Paraqitja e QR kodit nga paguesi (ang. Payer-presented) i mundëson paguesit të kryejë pagesa duke përdorur kredencialet e lidhura me një llogari dhe të ruajtura në pajisjen e tij. Paguesi gjeneron një QR kod nga aplikacioni i tij nga pajisja telefonike dhe i paguari e skanon QR kodin, komunikon me ofruesin e shërbimit të pagesës së paguesit, i cili më pas fillon pagesën (me miratimin e qartë të paguesit) për mallrat dhe/ose shërbimet dhe në fund i dërgon të paguarit konfirmimin e pagesës. Ky model i mbështetë pagesat online, pagesat në POS, deponimin dhe tërheqjen e parave të gatshme.

Neni 7

Modeli i implementimit

Modeli i implementimit të QR kodit në Kosovë bazohet në modelin e decentralizuar, ku secili pjesëmarrës duhet të ofrojë teknologjinë e tij për gjenerimin, dekodimin, deshifrimin dhe verifikimin e një QR kodi, duke përfshirë kryerjen e tokenizimit dhe detokenizimit, nëse është e aplikueshme.

Neni 8

Tipet e QR kodit

1. QR kodet klasifikohen në:
 - 1.1. QR kodi statik
 - 1.2. QR kodi dinamik

Neni 9

QR kodi statik

1. Një QR kod statik përmban informata që janë fikse dhe nuk mund të ndryshohen pasi të gjenerohet QR kodi. Një QR kod statik, pasi të gjenerohet, mund të përdoret për transaksione të shumta. QR kodet statike kanë kërkesa më të ulëta, pasi vetëm njëra nga palët ka nevojë për një pajisje telefonike funksionale, kurse pala tjetër mund të përdorë një QR kod të printuar.
2. QR kodet statike mund të përdoren në rastet e paraqitjes së QR kodeve nga i paguari (ang. Payee-presented), por edhe në rastet e paraqitjes QR kodit nga paguesi (ang. Payer-presented).
3. QR kodet statike janë të përshtatshme për tregtarët e vegjël që kodojnë detajet e tyre të pagesës në QR kod. Ky mund të jetë gjithashtu i përshtatshëm për transaksione me një shumë fikse (siç janë biletat e autobusit). QR kodi mund të skanohet nga konsumatori duke përdorur aplikacionin e tij nga pajisja telefonike dhe, nëse kërkohet, konsumatori mund të vendosë shumën kur i kërkohet ta bëjë këtë. Informacioni i tregtarit, si emri i dyqanit, shfaqet në

pajisjen telefonike për verifikim dhe pasi pagesa konfirmohet nga konsumatori, pagesa iniciohet.

4. Në kontekstin e QR kodeve statike të paraqitura nga konsumatori, ato mund të përdoren në krijimin e Identiteteve Financiare për të pasur çasje në shërbime të ndryshme bankare.
5. QR kodet statike janë më tepër të ekspozuara ndaj rreziqeve se sa ato të QR kodit dinamik, pasi ndonjë mashtrues mund të mbivendosë QR kodin e tregtarëve (në rastin e QR kodit statik të paraqitur nga tregtari) me një QR kod të falsifikuar ose të fotografojë një QR kod të konsumatorit dhe shumat e transaksionit paguhen në llogarinë e gabuar të pagesës (Payee). Në mënyrë që të zvogëlohen këto raste, ka disa veprime lehtësuese që mund të përdoren, si p.sh. përdorimi i një tokeni ose URL në vend të kredencialeve të pagesës. Tokeni ose URL pastaj përdoren për të nxjerrë detajet e pagesës.
6. Në shembullin e paraqitur në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi “Diagramet dhe rrjedha e pagesës”, në Figurën 4: QR kodit statik me të dhënat e paraqitura nga i paguari dhe rrjedha e pagesave, është paraqitur skenari ku kredencialet e pagesës përfshihen në QR kod (pra jo në skenarin ku përdoret një Token ose URL).

Neni 10 **QR kodi dinamik**

1. Në rastin e një QR kodi dinamik, një kod i ndryshëm gjenerohet për çdo transaksion. Kjo i bën këto kode më të përshtatshme për qëllime pagesash dhe biznesi. QR kodet dinamike përdoren zakonisht në pagesa, pagesa e-commerce, pagesa të faturave si dhe pagesa në kioskat e vetë-shërbimit.
2. QR kodet dinamike mund të aplikohen në rastet e paraqitjes së kodit nga i paguari (Payee-presented) dhe nga paguesi (Payer-presented).
3. Një rast tipik i përdorimit të QR kodit dinamik me paraqitjen e të dhënave nga i paguari (Payee-presented) është pagesa për blerjet në internet, ku një konsumator blen mallra ose shërbime dhe më pas kalon në arkë (ang. checkout) në një dyqan online, ku tregtari e gjeneron QR kodin dinamik dhe ia paraqet konsumatorit në skanim, duke përfshirë detajet e transaksionit. Konsumatori më pas e skanon QR kodin dinamik me një aplikacion të pajisjes telefonike (detajet e transaksionit për të inicuar pagesën). Informatat lidhur me tregtarin (siç është emri i tregtarit) dhe informatat variable të faturës (siç është shuma e pagesës) shfaqen në pajisjen telefonike për verifikim përpara se të fillojë pagesa.
4. Në rastin e përdorimit të QR kodeve dinamike me të dhënat e paraqitura nga paguesi (Payer-presented mode), konsumatori që dëshiron të depozitojë para (Cash in) mund të gjenerojë një QR kod duke përdorur aplikacionin në pajisjen e tij telefonike që tregon ofruesin e shërbimeve të pagesave të pjesëmarrësit (Agjenti CICO) në të cilin ata dëshirojnë të depozitojnë paratë dhe llogarinë e tyre. Më pas dërgohen paratë e gatshme te ofruesi i shërbimit të pagesave të

pjesëmarrësit (Agjenti CICO) i cili më pas do të skanojë QR kodin dhe do të marrë paratë, të cilat më pas pasqyrohen menjëherë si kredi në llogarinë e konsumatorit.

5. Në shembullin e paraqitur në Shtojcën 2 në Figurën 5: Kodi QR dinamik me të dhënat e paraqitura nga i paguari dhe Rrjedha e Pagesave, " Diagramet dhe rrjedha e pagesës " është paraqitur skenari ku kredencialet e pagesës përfshihen në QR kod (pra jo në skenarin ku përdoret një Token ose URL).

Neni 11

Shembulli i përdorimit në Republikën e Kosovës

1. Shembulli i përdorimit të Kodit QR në Republikën e Kosovës është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Mapimi i rasteve të parashikuara të QR kodit:

	Rasti i përdorimit	Modi i QR kodit i përdorur	Tipi i QR kodit
1	Transferim i menjëhershëm i kreditit	Paraqitja e QR kodit nga i paguari	Dinamik
2	Inicimi i pagesës	Paraqitja e QR kodit nga i paguari	Statik Dinamik
3	E-commerc	Paraqitja e QR kodit nga i paguari	Dinamik
4	Kërkesa për pagesë	Paraqitja e QR kodit nga i paguari	Dinamik
5	Paraqitja dhe pagesa e faturës	Paraqitja e QR kodit nga i paguari	Statik Dinamik
6	Deponimi	Paraqitja e QR kodit nga paguesi	Dinamik
7	Tërheqja	Paraqitja e QR kodit nga paguesi	Dinamik

Neni 12

Palët e përfshira/akterët

1. Palët e përfshira në procesin e realizimit të pagesave me QR kod dhe të përmendura në këtë udhëzim, janë si vijon:

- 1.1. **“Ofrues i shërbimit të pagesave (PSP) që ofron dhe mban një llogari pagese -Account Servicing Payment Service Provider (ASPSP)”**: Çdo person fizik ose juridik të licencuar, regjistruar ose autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për të ofruar shërbim pagese;

- 1.2. **“Agjentët Cash In Cash-out (ang. Cash-in Cash-out Agent (CICO Agent))”**: Agjentët Cash In Cash-out zakonisht veprojnë në zona ku bankat tradicionale nuk janë të pranishme. Disa nga shërbimet që ofrohen përmes këtij shërbimi financiar përfshijnë depozita në para, tërheqje cash, pagesa faturash dhe transfera parash në celular.
- 1.3. **FPS**: Sistemi i shlyerjes së pagesave të shpejta-instant, që do të implementohet nga BQK.
- 1.4. **“Konsumator”** Personi që blen/përdor mallrat dhe/ose shërbimet (Payer). Mund të jetë një biznes i cili blenë produkte ose shërbime.
- 1.5. **“HUB”**: “Infrastruktura” që mundëson ndërlidhjen ndërmjet ofruesve të shërbimeve përkatëse MCT dhe palëve të tjera të interesuara në ekosistemin e QR kodit. Mund të jenë rrjetet ekzistuese, FPS e ardhshme e BQK-së ose ndonjë rrjet tjetër ndërbankar.
- 1.6. **“Aplikacioni i transferit të kreditit mobil (ang. Mobile (instant) Credit Transfer Application (MCT App))”**: Aplikacioni celular i vendosur në pajisjen celulare dhe ofrohet nga Ofruesi i Shërbimit MCT.
- 1.7. **“Ofruesi i shërbimeve të transferit të kreditit mobile (ang. Mobile (instant) Credit Transfer (MCT) Service Provider:)”** Një ofrues shërbimi që ofron ose lehtëson një shërbim MCT për një pagues ose të paguar bazuar në një transaksion pagese të shpejtë. Kjo mund të përfshijë ofrimin e një aplikacioni të dedikuar MCT për shkarkim në pajisjen telefonike të klientit ose ofrimin e softuerit të dedikuar për POI-në e tregtarit (fizik ose virtual). Si shembull, një ofrues shërbimi MCT mund të jetë një PSP (p.sh. një ASPSP ose ndonjë palë që vepron si PISP nën PSD2) ose një ofrues shërbimi teknik që mbështet një PSP. Shënim: Ofruesi i Shërbimeve MCT dhe ASPSP mund të jenë i njëjti institucion dhe në shumë raste është kështu.
- 1.8. **“Tregtari”**: Një përfitues brenda një skeme pagese për pagesën e mallrave ose shërbimeve të blera nga konsumatori. Një tregtar mund të quhet edhe i paguari, d.m.th., përfituesi/kreditori në transaksion dhe përfshin individë privatë, biznese, korporata, qeveri, etj.
- 1.9. **“Pala referuese e të paguarit (ang. Payee reference party)”**: Një person ose entitet në emër të të cilit përfituesi pranon pagesën
- 1.10. **“I paguari (ang. Payee)”** Një person fizik ose juridik i cili është marrësi/përfituesi i synuar i fondeve (shembuj përfshijnë tregtar, biznes dhe një individ);
- 1.11. **“Paguesi (ang. Payer)”** Një person fizik ose juridik që mban një llogari pagese dhe lejon një urdhërpagesë nga ajo llogari pagese, ose, kur nuk ka llogari pagese, një person fizik ose juridik që jep urdhër për fillimin e një pagese;
- 1.12. **“Lëshuesi i ngarkesës së pagesës (ang. QR Payload Issuer)”** Subjekti përgjegjës për lëshimin e ngarkesës së pagesës. Ky mund të jetë ofruesi i shërbimit MSCT ose një subjekt tjetër (p.sh. një blerës), që vepron nën këtë ofrues të shërbimit MSCT;
- 1.13. **“Ofruesi i shërbimeve të tokenit (ang. Token Service Provider (TSP))”**: Është një palë e tretë e besueshme e cila ofron shërbime të tokenizimit, ku përfshihen vlera surrogate për informata sensitive lidhur me identifikimin e të dhënave të transaksionit të paguesit dhe të paguarit. TSP menaxhon dhe gjeneron tokena, mirëmbanë dhe mapon tokena dhe

të dhëna që ndërlidhen me to. TSP përfshinë tokenizimin e të dhënave sensitive dhe dokenizimin e tokenit, duke nxjerrë të dhënat e transaksioneve.

2. Disa nga akterët/funksionet e sipër përmendura ushtrohen nga të njëjtat subjekte, duke e bërë më të vogël numrin e palëve të përfshira në rrjedhën e pagesave.
3. Në veçanti, ASPSP e konsumatorit do të jetë gjithashtu ofruesi i shërbimit MCT të konsumatorit dhe, në rast të QR kodit të paraqitur nga konsumatori, gjithashtu do të jetë lëshuesi i ngarkesës së pagesës dhe ofruesi i shërbimit token. Ky akter do të quhet pjesëmarrësi i paguesit.
4. ASPSP-ja e biznesit do të jetë gjithashtu ofruesi i shërbimit MCT të biznesit dhe tek rasti i QR kodit të paraqitur nga biznesi, gjithashtu edhe lëshuesi i ngarkesës së pagesës dhe ofruesi i shërbimit token. Ky akter do të quhet pjesëmarrësi i të pagurit.
5. Figura 2 dhe 3 e Shtojcës 2 “Diagrami dhe rrjedha e pagesave” tregon diagramin konceptual të thjeshtuar për palët e interesuara/akterët e ekosistemit të QR kodit të Kosovës për biznese dhe konsumator.

Neni 13

Kërkesat e sigurisë për QR kod

1. Ky udhëzim i shqyrton çështjet e sigurisë që lidhen specifikisht me QR kodin (siç është siguria mes paguesit dhe të paguarit). Aspektet e sigurisë që lidhen me teknologjitë e tjera të përafërimit (proximity technologies) për shkëmbimin e mesazheve midis klientëve, ASPSP-ve, ofruesve të shërbimeve MCT, TSP-ve etj, nuk mbulohen dhe duhet të specifikohen nga skema përkatëse.
2. Një QR kod mund të përmbajë të dhëna të ndjeshme dhe jo të ndjeshme që mund të përdoren nga palë të ndryshme të përfshira në përpunimin e transaksioneve MCT. Të dhënat jo të ndjeshme përfshijnë informacionin e aplikacionit si emrin e paguesit apo të paguarit, URL-në e shkarkimit, etj, këto të dhëna mund të mbeten të pa siguruara. Të dhënat e ndjeshme përfshijnë IBAN, apo një identifikues të paguesit, siq është ID-ja e klientit janë kredencialet e paguesit për të hyrë në sistemin bankar në internet).
3. Përgjimi ose ndërhyrja në të dhënat e ndjeshme mund të çojë në transaksione të rreme ose rrjedhje të të dhënave dhe, si e tillë, masat e sigurisë duhet të zbatohen për të mbrojtur të dhënat e ndjeshme dhe integritetin e elementeve të të dhënave brenda QR kodit. Për shembull, të dhënat e ndjeshme nuk duhet të përfshihen në QR kodin në formë të lexueshme dhe duhet të përdoren teknika për të siguruar integritetin e elementeve të të dhënave brenda QR kodit.
4. Në standardin e QR kodit, të dhënat e ndjeshme mbrohen përmes përdorimit të tokenëve dhe proksive (ndërmjetësve) dhe integriteti i të dhënave mbrohet përmes përfshirjes së një fushe të Kontrollit të Integritetit (ang. Integrity Check field) në implementimin kombëtar.

5. Për të dyja modelet, masat e duhura të sigurisë duhet të zbatohen nga subjekti/aplikacioni që krijon QR kodin dhe të përfshijë masat shtesë të mëposhtme:
 - 5.1. Aplikacioni MCT nuk duhet të lejojë përdorimin e funksionit të fotografimit të ekranit (ang. screenshot) kur shfaq QR kodin ose të njoftojë anën e serverit ose t'a bëjë të pavlefshëm QR kodin të shfaqur kur zbulon një sulm të fotografimit të ekranit.
 - 5.2. Pajisja e pagesit dhe të paguarit duhet të jetë në gjendje të njohë kodet e paligjshme dhe t'i refuzojë ato ose të shfaqë mesazh paralajmërues.

Neni 14 **Shtojcat**

1. Shtojcat e mëposhtme janë pjesë integrale e këtij udhëzimi:
 - 1.1. Shtojca 1 - EPC Specifikat e QR kodit për pagesa
 - 1.2. Shtojca 2 - Diagramet dhe rrjedha e pagesave
2. Shembujt në shtojcën 1 janë përfshirë vetëm për të kuptuar më mirë përdorimin e standardeve të QR kodit, por nuk janë pjesë e standardit. Përshkrimi i detajuar se si përdoret QR kodi për raste të ndryshme përdorimi do të përcaktohet në rregullat përkatëse të skemës së QR kodit

Neni 15 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim do të hyjë në fuqi më 1 tetor 2024, ndërsa deri më 1 qershor 2025 duhet të arrihet përshtatja e plotë me kërkesat e këtij udhëzimi.

Shtojca 1

1. SPECIFIKAT E EPC STANDARDIT PER PAGESA ME QR KOD

Standardi EPC i QR kodit është zhvilluar për të mbështetur QR kodet për transferet SEPA Instant të kreditit të bazuara në llogari, por fokusi tani është zgjeruar në sigurimin e ndërveprimit të transfertave të kreditit të iniciuara nga pajisjet telefonike në gjithë zonën e SEPA-s, por edhe më gjerë në kontinentin Evropian. Standardi i EPC i QR kodit, i njohur si "Standarizimi i QR kodit për transfertat SEPA (Instant) të kreditit të nisura nga pajisjet telefonike [EPC024-22v2]", u zhvillua nga Grupi shume-palësh për transferet e kreditit SEPA të iniciuara nga pajisjet telefonike (MSG MCT). Në zhvillimin e standardit, MSG MCT është bazuar në versionin e mëparshëm të "Standardizimi dhe qeverisja e kodeve QR për FPS në pika e ndërveprimit [EPC212-21v1.1]" dhe "Pagesat MCT dhe udhëzuesi për ndërveprim [EPC269-19v2]".

Standardi EPC për QR kodin përdoret si standard mbi të cilin specifikimi i këtij kodi për Kosovën është zhvilluar dhe përshtatur për t'iu përshtatur kërkesave vendore.

1.1. Konventa e shkurtesave të QR kodit

Lista e shkurtesave në Tabela 2: qe janë përdorur në këtë udhëzim.

Tabela 2: Shkurtesat

Shkurtesa	Përshkrimi
An	Alfanumerik
Ans	Alfanumerik Special
b	Këto objekte të dhënash përbëhen ose nga numra binarë të pacaktuara ose nga kombinime bitesh që janë përcaktuar diku tjetër në këtë udhëzim
C	E kushtëzuar
ISO	Organizata e standardeve ndërkombëtare
M	E detyrueshme
N / n	Numerike
O	Opcionale
QR Kod	Kodi i përgjigjes së shpejtë
RFU	E rezervuar për përdorim në të ardhmen
S	String
Var	Variabël

Objektet e të dhënave duhet të jenë në një prej formateve të listuara në tabelën 3: Formatet e objekteve të të dhënave

Tabela 3: Formatet e objekteve të të dhënave

Formati	Përshkrimi
Numerik (N/n)	Vlerat mund të jenë shifra, nga "0" në "9".
Alfanumerik(an)	Alfanumerik; përmbanë nga një karakter për bajt Karakteret e lejuara janë alfabetike (a deri z dhe A deri Z) dhe numra (0 deri 9)
Alfanumerik Special (ans)	Vlerat që mund të përfshijnë grupin e karaktereve të përbashkëta (ang. Common Character Set). Alfabeti alfanumerik special përfshin gjithsej nëntëdhjetë e gjashtë (96) karaktere dhe përfshin alfabetin numerik dhe shenjat e pikësimit
B	Këto objekte të dhënash përbëhen ose nga numra binarë të pacaktuar ose nga kombinime bitesh që janë përcaktuar diku tjetër në këtë udhëzim
Cn	Objektet e të dhënave numerike të kompresuara përbëhen nga dy shifra numerike (që kanë vlera në diapazonin Hex '0'-'9') për bajt. Këto objekte të dhënash lihen të justifikuara dhe të mbushura me 'F' heksadecimal pasues
String (S)	Vlerat e përfaqësuara nga çdo karakter(a) i parakompozuar i përcaktuar në [Error! Reference source not found.].

1.2. Konventat ose rregullat e QR kodit

Kodimi i fushave të ndryshme të të dhënave në QR kod duhet të standardizohet siç përcaktohet në pjesë më poshtë. Ngarkesa e pagesës (ang. payload) duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë dokument dhe të përfshijë të dhënat minimale (d.m.th. të gjitha fushat e detyrueshme) siç përshkruhet në këtë seksion. Fushat opsionale janë në diskrecionin e lëshuesit të ngarkesës së pagesës (ang. payload issuer). Për më tepër, parametrat duhet të strukturohen në mënyrë që URL-ja në tërësinë e saj të jetë e vlefshme sipas specifikimit të URL-së (<https://www.w3.org/Addressing/URL/url-spec.txt>).

1.2.1. Gjurmueshmëria e QR kodit

QR kodi mund të identifikohet në mënyrë unike duke përdorur referencën e dërgesave për metodat e proksi dhe tekstit të pastër dhe duke përdorur një token për metodën e tokenizimit. Ofruesi i Shërbimit MCT që gjeneron transaksionin duhet ta lidhë këtë transaksion me referencën ose tokenin për të garantuar gjurmueshmërinë e plotë të transaksionit nga fundi në fund (ang. end-to-end) duke filluar nga iniciimi i transaksionit.

1.2.2. Kodimi i QR kodit

Për konvertimin e një karakteri në vlerën e tij binare, përdoret kodimin UTF-8 siç përcaktohet nga Unicode¹. Një karakter në UTF-8 mund të jetë deri në 4 bajt në varësi të gjuhës. Në UTF-8, 128 karakteret e para kodohen duke përdorur 1 bajt (karakteret ASCII) dhe grupin e zgjeruar të karaktereve UTF-8 (d.m.th. 1920 karakteret e radhës janë të koduara duke përdorur 2 bajt), ku mbështeten edhe karakteret cirilike (karakteret cirilike përdorin 2 bajt).

1.2.3. Seti i karaktereve të koduara

Për qëllimet e këtij standardi të QR kodit, shumica e elementeve të të dhënave do të përdorin grupin standard të karaktereve UTF-8, kurse disa elementë të të dhënave, si emrat e njerëzve dhe vendeve, do të përdorin grupin e zgjeruar të karaktereve UTF-8 për të mbështetur karakteret cirilike. Elementet e të dhënave që përdorin grupin e karaktereve të zgjeruar UTF-8 do të shënohen si të tillë.

1.2.3.1. Dimensioni dhe niveli i korrigjimit të QR kodit

Në përgjithësi, QR kodet më pak të dendura lexohen më lehtë nga skanerët, ndërsa QR kodet më të dendura janë më të vështira për t'u lexuar. Në mënyrë të ngjashme, QR kodet me dimensione fizike më të mëdha janë më të lehta për t'u lexuar sesa QR kodet me dimensione fizike më të vogla. QR kodet duhet të optimizohen në mënyrë që të mos mbajnë të dhëna të parëndësishme ose të tepërta dhe të kenë dimensione fizike mjaftueshëm të mëdha për të lehtësuar leximin.

Për të arritur rezultatin më të mirë, rekomandohet një madhësi totale jo më e madhe se 512 karaktere alfanumerike. Për më tepër, nivelet më të larta të korrigjimit të gabimeve rrisin densitetin e QR kodit. Nivelet më të ulëta të korrigjimit të gabimeve rezultojnë në një QR kod më pak të dendur. Rekomandohet një nivel korrigjimi i gabimit "L".

1.3. Struktura e URL të QR kodit

Struktura e të dhënave të QR kodit është e bazuar në URL dhe përbëhet nga pesë pjesë:

- Pjesa e parë e URL-së: struktura e zakonshme e domenit.
- Pjesa e dytë e URL-së: versioni.
- Pjesa e tretë: Iloji (kjo mund t'i referohet kontekstit të pagesës).
- Pjesa e katërt: Një identifikues i ofruesit të shërbimit MCT që i nevojitet Hub-it për qëllime të rutimit për shkëmbimin e mesazheve ndërmjet ofruesve përkatës të shërbimit MCT.
- Pjesa e pestë: informacioni i ngarkesës së pagesës (payload).

Katër pjesët e para të strukturës, në dokument do të jenë të referuara si URL heder (ang. URL header)

¹ <https://home.unicode.org/>

Struktura URL e QR kodit është përcaktuar si më poshtë:

QR kodi i paguari prezent (Payee presented QR Code)
/HTTPS://<Emri i domenit>/<Verzioni>/<Tipi>/<ID e ofruesit të shërbimeve të të paguarit (ang. Payee MCT service provider ID)>/<Ngarkesa e pagesës(payload)>
QR kodi paguesi prezent (Payer presented QR Code)
/HTTPS://<Emri i domenit>/< Verzioni >/<Tipi>/< ID e ofruesit të shërbimeve të të paguesit(ang. Payer MCT service provider ID)>/< Ngarkesa e pagesës(payload)>

1.3.1. Metodatat e ngarkesës së pagesës (payload) së QR kodit

Në kontekstin e QR kodeve të paraqitura nga i paguari (Payee-presented), standardi parashikon tre metodatat e mëposhtme të ngarkesës së pagesës (payload) së QR kodit:

- *Të dhënat e paraqitura nga i paguari me token* përfshijnë një token të të paguarit (ang. *Payee token*) në të cilin rast një proces detokenizimi duhet të kryhet duke përdorur tokenin e dhënë në ngarkesën së pagesës së QR kodit që i është dhënë paguesit nëpërmjet ofruesit të shërbimit MCT për të nxjerrë detajet e pagesës (identifikimi i të paguarit dhe të dhënave e transaksionit). Kjo kërkon ndërlidhjen me ofruesin e shërbimit MCT të të paguarit përpara fillimit të transaksionit MCT.
- *Të dhënat e paraqitura nga i paguari me proksi* përfshijnë një proksi për të dhënat e identifikimit të të paguarit, në të cilin rast të dhënat në lidhje me proksi duhet të sigurohen nga ofruesi i shërbimit MCT të të paguarit me kërkesë nga ofruesi i shërbimit MCT të paguesit përpara fillimit të transaksionit MCT.
- *Të dhënat e paraqitura nga i paguari me tekst të pastër* përfshijnë (d.m.th., emri i përfituesit, emri tregtar, IBAN i llogarisë së përfituesit, shuma e transaksionit, etj. janë të gjitha në tekst të pastër). Transaksioni MCT mund të iniciohet menjëherë duke përdorur këto të dhëna.

QR kodi i paguari prezent (Payee presented QR Code)
QR kodi me Token [Verzioni]+[Tipi]+ [ID e ofruesit të shërbimeve MCT të të paguarit] + [tokeni i të paguarit]
QR kodi me proksi [Verzioni]+[Tipi]+ [ID e ofruesit të shërbimeve MCT të të paguarit]+ [proksi] + [një string me emrin/vlerën si tekst i pastër]
QR kodi me të dhëna tekst të pastër [Verzioni]+[Tipi]+ [ID e ofruesit të shërbimeve MCT të të paguarit]+ [një string me emrin/vlerën si vlerën si tekst i pastër]

8

Metoda me proksi dhe të dhëna teksti të pastër lejohet vetëm për përdorim kombëtar. Për përdorim ndërkombëtar, lejohet vetëm metoda me token.

Në dy metodat fundit të përshkruara më sipër, duhet të zbatohen masat e duhura të sigurisë për të garantuar integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave siç përshkruhet në Nenin 13 të këtij udhezimi “Kërkesat e sigurisë së QR kodit”.

Në planin kombëtar, ofruesi i shërbimit MCT të të paguarit duhet të mbështesë të tre opsionet e specifikuar më sipër në mënyrë që i paguari të zgjedhë opsionin më të mirë në varësi të rastit të përdorimit dhe ofruesi i shërbimit MCT të paguesit duhet të jetë në gjendje të mbështesë të gjitha llojet.

Në kontekstin e QR kodeve të paraqitura nga paguesi, standardi parashikon metodën e mëposhtme të ngarkesës së pagesës së QR kodit:

- *Të dhënat e paraqitura nga paguesi me token* në të cilin rast duhet të kryhet një proces detokenizimi duke përdorur kodin e dhënë në ngarkesën e pagesës së QR kodit që i është dhënë të paguarit nëpërmjet ofruesit të shërbimit MCT për të nxjerrë detajet e pagesës (Identifikimi i paguesit dhe të dhënat e transaksionit). Kjo kërkon ndërlidhjen me ofruesin e shërbimit MCT të paguesit përpara fillimit të transaksionit MCT.

QR kodit i paguesit prezent (Payer presented QR Code)
--

<i>QR kodit me token</i>

[Verzioni]+[Tipi]+ [ID e ofruesit të shërbimeve MCT të paguesit] + [tokeni i paguesit]
--

Në kontekstin e QR kodeve të paraqitura nga paguesi (ang. Payer-presented), opsionet që përmbajnë ID-të e Klientit (ID-të e klientit mund të jenë kredencialet e një paguesit për qasje në sistemin bankar online) në tekst të pastër nuk lejohen, por lejohen vetëm në rastet kur të dhënat e identifikimit të paguesit janë me token (përveç nëse shprehimisht shprehet ndryshe dhe kredencialet e paguesit janë të mbrojtura). Por grupi i të dhënave mund të përfshijë gjithashtu një varg shtesë me vlerë teksti të pastër për të mbështetur shërbime shtesë me vlerë të shtuar (p.sh. programet e besnikërisë).

1.3.2. Definimi i fushave të të dhënave të hederit URL

1.3.2.1. Emri i domenit

Emri i domenit i referohet një kuadri ose skeme të ndërveprueshmërisë MCT, d.m.th., në domenin e ndërveprueshmërisë për ofruesit e shërbimeve MCT dhe duhet t'i referohet një "kornizë ndërveprueshmërie MCT" ose "një skeme ose pjesëmarrësi MCT" që operohet sipas kornizës së ndërveprimit MCT. Për të ofruar fleksibilitet maksimal dhe administrim të decentralizuar të aplikacioneve lokale, emri i domenit duhet të mbështesë domenin kryesor (qr.INTFRM.org), nënfushat pasuese (xy.INTFRM.org) dhe URL-në lokale (qr.xy.xy). Për ndërveprueshmërinë

WB6, do të përcaktohet një emër specifik domaini. Për përdorim të brendshëm, emrat e domenit përcaktohen në bazë të rasteve specifike të përdorimit.

Tabela 4: Emrat e domenit

Vlera	Përshkrimi	Pronari i domenit	Tipi i QR kodit
xxx.qrc.bqk-kos.org	Pagesa kombëtare	BQK	Të gjitha

BQK-ja do të përcaktojë emrat e lejuar të domeneve për transaksionet ndërkombëtare në një fazë të mëvonshme.

Lista e emrave të domeneve të lejuara menaxhohet dhe autorizohet vetëm nga BQK-ja.

1.3.2.2. Verzioni

Versioni i referohet versionit specifik të QR kodit dhe lejon përditësimet e ardhshme të QR kodit. Aktualisht është:

/1/ që i referohet versionit të parë të QR kodit.

1.3.2.3. Tipi

Tipi tregon se çfarë lloj konteksti pagese pritet. Konteksti i paracaktuar i pagesës mund të përcaktojë gjithashtu se çfarë lloj parametrash të pyetjes (ang. queries) do të lejohen në ngarkesën e pagesës, p.sh., për shkak të çështjeve të sigurisë, një QR kod i përdorur në pikën e ndërveprimit nuk do të lejonte të dhëna me tekst të pastër.

Tabela 5: Tipi – Lloji i pagesës

Vlera	Modi i QR kodit	Përshkrimi	Standardi EPC për nevojat e Kosovës	Metoda e lejuar
<i>Tipet e standardit EPC</i>				
/m/	QR kodi i paguari prezent	Pagesat me mobil në pikën e ndërveprimit	Standardi EPC	Token
/e/	QR kodi i paguari prezent	Pagesat e-commerce dhe m-commerce	Standardi EPC	Token
/i/	QR kodi i paguari prezent	Pagesat e faturave	Standardi EPC	Proksi/tekst i pastër
/p/	QR kodi i paguari prezent	Pagesat person-te-person	Standardi EPC	Token
/w/	QR kodi i paguari prezent	Hapja e URL në WebView (p.sh. pikën e ndërveprimit virtual).	Standardi EPC	Token

Llojet shitesë mund të përcaktohen për rastet e përdorimit kombëtar.

1.3.2.4. Identifikuesi e ofruesit të shërbimeve MCT

Një identifikues i standardizuar duhet t'i caktohet çdo ofruesi të shërbimit MCT për qëllime të indentifikimit në procesim (ang. routing). Kjo do të kërkojë kontrollimin e përshtatshmërisë dhe regjistrimin e ofruesit të shërbimit MCT sipas Skemës FPS. BQK do të jetë përgjegjëse për lëshimin e ID për ofruesit të shërbimeve MCT. Operatori FPS do të jetë përgjegjës për lëshimin e ID-së së ofruesit të shërbimit MCT. Identifikuesi i ofruesit të shërbimit MCT kërkohe për qëllime të rrugëtimit dhe shkëmbimit të mesazheve ndërmjet ofruesve përkatës të shërbimit MCT. Kodimi i ID-së së ofruesit të shërbimit MCT duhet të jetë 3 karaktere alfanumerik (an).

1.3.2.5. Objektet e të dhënave të hederit

Në tabelat e mëposhtme, të dhënat e hederit janë renditur.

Interpretimi i tabelës

- **ID e fushës:** Kjo është një vlerë që përdoret për t'iu referuar lehtësisht një fushë, por nuk përdoret në QR kodin.
- **Emri i objektit të të dhënave:** Është emri gjenerik i fushës
- **Formati:** Format i fushës siç përshkruhet në Tabelën 3: Formatet e objekteve të të dhënave
- **Gjatësia:** Gjatësia e fushës
- **Seti i karaktereve:** Tregon grupin e karaktereve të zbatueshme për atë element të të dhënave.
 - UTF-8 Std = nëngrup standard i karaktereve UTF-8
 - UTF-8 EXT = grup i zgjeruar karakteresh që përfshin karakteret cirilike
- **Vlera:** Vlera e paracaktuar kur është e aplikueshme
- **Përshkrimi dhe rregullat:** Përshkruan fushën dhe përcakton rregullat dhe kushtet aty ku zbatohen

ID e fushës	Emri i objekteve të të dhënave	Formati	Gjatësia	Seti i karaktereve	Vlera	Përshkrimi dhe rregullat
<i>Hederit</i>						
H01	Emri i domenit	ans	Var deri në 70	Standardi UTF-8	xxx.qrc.bqk-kos.org	Emri i domenit i referohet domenit të ndërveprueshmërisë për ofruesit e shërbimeve MCT ose

ID e fushës	Emri i objekteve të të dhënave	Formati	Gjatësia	Seti i karaktereve	Vlera	Përshkrimi dhe rregullat
<i>Heder</i>						
						domenit kombëtar të QR kodit
H02	Verzioni	n	1	Standardi UTF-8	1	Verzioni i QR kodit
H03	Tipi	an	1	Standardi UTF-8		Seksioni 1.3.2.3
H04	Ofruesi i shërbimeve MCT	an	3	Standardi UTF-8		Përdoret për qëllime të rutimit (në rast të përdorimit të tokenit ose proksit)

1.3.3. Të dhënat e pagesës (Payload Data)

1.3.3.1. Struktura e të dhënave të pagesës

Objektet e të dhënave në ngarkesën e pagesës duhet të ndjekin sekuencën siç përcaktohet në Nenin 1.3.3.2 të këtij udhëzimi “Objektet e të dhënave të ngarkesës”.

Parametrat standardë të pyetësorit (ang. query) të URL-së përdoren për të kufizuar objektet e të dhënave brenda ngarkesës: Karakteri "?" përdoret si parametër fillestar për ngarkesën e pagesës, kurse karakteri "&" si kufizues i të dhënave të informacionit brenda ngarkesës së pagesës. Fushat e ngarkesës së pagesës definoohen me një emër me dy ose tre shkronja të ndjekura nga karakteri "=" dhe të ndara me &. Fushat përcaktohen si të detyrueshme, të kushtëzuara ose opsionale, në varësi të metodës, llojit dhe rastit të përdorimit. Nëse një fushë opsionale ose e kushtëzuar nuk përdoret, emri i fushës nuk do të jetë i pranishëm në ngarkesën e pagesës. Në nenin 1.3.4 të këtij udhëzimi gjendet shembulli i ngarkesës së pagesës.

Standardet EPC e lejojnë përcaktimin e strukturës së ngarkesës së pagesës në tregjet kombëtare. Për tregun nderkombëtar, lejohet vetëm ngarkesa e pagesës me metodën token.

Lista e emrave të lejuar të fushave menaxhohet dhe autorizohet vetëm nga BOK-ja.

1.3.3.2. Objektet e të dhënave të pagesës (payload)

Në tabelat më poshtë renditen të dhënat e ngarkesës për tre metodat e ngarkesës së QR kodit të paraqitura nga paguesi dhe një metodë nga paguesi, siç përcaktohet në Nenin 1.3.1 të këtij udhëzimi "Metodat e ngarkesës së QR kodit". Qëllimi i tabelës më poshtë është të sigurojë një listë të plotë të objekteve të të dhënave.

Interpretimi i tabelës

- **Emri i fushës:** Vlera e cila identifikon fushën brenda ngarkesës së pagesës
- **Emri i objektit të të dhënave:** Emri gjenerik i fushës
- **Formati:** formati i fushës siç përshkruhet në Tabelën 5: Formatet e objekteve të të dhënave
- **Gjatësia:** Gjatësia e fushës
- **Seti i karaktereve:** Tregon grupin e karaktereve të zbatueshme për atë element të dhënash.
 - UTF-8 Std = nëngrup standard i karaktereve UTF-8
 - UTF-8 EXT = Set i zgjeruar i karaktereve që përfshin karakteret cirilike.
- **QR kodi përmbanë:** Është e ndarë në tri pjese (Token, Proksi apo tekst i pastër) dhe është e formatuar si më poshtë:
 - M = Obligative (ngjyrë e kuqe)
 - C = E kushtëzuar dhe e nevojshme nën kushte të caktuara (ngjyra portokalle)
 - O = Opcionale (ngjyrë e gjelbër)

Nëse fusha nuk është e aplikueshme, shënohet me ngjyrë gri.

- **Vlera:** Vlera e paracaktuar në rastet kur aplikohet
- **Përshkrimi dhe rregullat:** Përshkruan fushën dhe përcakton rregullat dhe kushtet aty ku aplikohen

2

Tabela 1: Lista e objekteve të të dhënave për QR kodin në rastin e të paguarit prezent

Emri i fushës	Emri i objektit të të dhënave	Formati	Gjatësia	Seti i Karaktereve	QR kodit përmbanë			Vlera	Përshkrimi dhe rregullat
					Tokeni	Proksi	Tekst i pastër		
Ngarkesa e pagesës									
Pmt=	Metoda e ngarkesës së pagesës (ang. payload method)	an	1	UTF-8 Std		O	O		<ul style="list-style-type: none"> Identifikohet metoda e ngarkesës së pagesës për tipet e QR që lejojnë më shumë se një metodë "1" - Tekst i pastër "2" - Proksi "3" - Token
Pid=	ID e lëshuesit të ngarkesës së pagesës së QR (ang. QR Payload Issuer ID)	an	var deri në 5	UTF-8 Std	O	O	O		<ul style="list-style-type: none"> Identifikohet pala e cila e gjeneron QR kodit. Nuk kërkohet nëse është i njëjtë me ofruesin e Shërbimit MCT
Tkn=	Tokeni	an	var deri në 300	UTF-8 Std	M				<ul style="list-style-type: none"> Tokeni duhet të jetë unik dhe t'i paraqesë të dhënat e transaksionit. Tokeni përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> Emri i mbajtësit të llogarisë Emri tregtar i të paguarit IBAN/Numri i llogarisë Kodi i kategorisë së të paguarit Tipi i instrumentit të pagesës Qëllimi i transferit të kreditit/Tipi i pagesës Informatat e remitancës Valuta e transaksionit Shuma e transaksionit Fusha tjera varësisht nga rasti i përdorimit

Pxt=	Tipi i proksit	ans	1	UTF-8 Std		M		<ul style="list-style-type: none"> • "1" - Numri i telefonit • "2" - ID Kombëtare • "3" - Numri i regjistrimit të biznesit • "4" - Skema e pagesës UID (RFU) 	
Prx=	Proksi	an	var. deri në 70	UTF-8 Std		M			
	Njëra duhet të jetë prezente në proksi	Numri i telefonit	N	var. deri në 15	UTF-8 Std				
		ID Kombëtare	N	10	UTF-8 Std				
		Numri i regjistrimit të biznesit	ans	9	UTF-8 Std				<ul style="list-style-type: none"> • Numri i biznesit të biznesit/korporatës
		Skema e pagesës UID (Alias)	ans	RFU	UTF-8 Std				
Anm=	Emri i mbajtësit të llogarisë	an	var. deri në 70	UTF-8 EXT			C		
Tnm=	Emri tregtar i të paguarit	an		UTF-8 EXT			O	<ul style="list-style-type: none"> • Obligative për C2B dhe B2B 	
Ibn=	IBAN	an	var. deri në 34	UTF-8 Std			C	<ul style="list-style-type: none"> • Kjo fushë e përmban IBAN • Gjatësia e kësaj fushe është përshtatur me standardin ndërkombëtar për IBAN, duke marrë parasysh iniciativat e ardhshme rajonale dhe ndërkombëtare • Nëse fusha IBAN është e pranishme, fusha ID e llogarisë nuk mund të jetë e pranishme 	

									Në disa raste të veçanta të përdorimit (si p.sh. KOS-GIRO), të dy IBAN dhe ID e llogarisë mund të mos jenë të pranishme
Aid=	ID e llogarisë	an	var. deri në 34	UTF-8 Std			C		<ul style="list-style-type: none"> Kjo fushë mund të ketë çfarëdo vlere që është ndryshe nga IBAN p.sh. ID e kuletës digjitale, numri i kartelës). Në rast se ASPSP nuk mund të nxirret nga ID e llogarisë, ID e ASPSP duhet të jetë prezente Nëse fusha ID e llogarisë është e pranishme, IBAN nuk mund të jetë e pranishme Në disa raste të veçanta të përdorimit (si p.sh. KOS-GIRO), të dy IBAN dhe ID e llogarisë mund të mos jenë të pranishme
Asp=	Shërbimi i llogarisë PSP	an	3	UTF-8 Std		C	C		<ul style="list-style-type: none"> Obligative kur ID e llogarisë nuk e përmbanë ID e ASPSP
Pcc=	Kodi i kategorisë së të paguarit (MCC)	an	4	UTF-8 Std		C	C		<ul style="list-style-type: none"> Obligative për C2B, B2B. Njihet si kodi i kategorisë së tregtarit. Duhet të jetë në pajtueshmëri me ISO 18245
Pit=	Tipi i instrumentit të pagesës	an	var. deri në 4	UTF-8 Std		M	M	ICT/RTG/ACH	<ul style="list-style-type: none"> ICT – Transferi I kreditit instant RTG – RTGS ACH – Automated Clearing House
Ppt=	Qëllimi i pagesës / Tipi i pagesës	an	var. deri në 4	UTF-8 Std		M	M		<ul style="list-style-type: none"> Të identifikojë llojin e Transaksionit të Pagesës dhe rastin e përdorimit të lidhur, siç përcaktohet nga rregullat e Skemës së BQK.

Rmt=	Informatat e remitancës	an	var. deri në 35	UTF-8 Std		M	M		<ul style="list-style-type: none"> • Informata specifike e transaksionit • Informacioni i dhënë nga paguesi në udhëzimin instant të kreditit dhe i transmetuar te i paguari për të lehtësuar barazimin e pagesës
Cur=	Valuta e transaksionit	an	var. deri në 3	UTF-8 Std		M	M	EUR	<ul style="list-style-type: none"> • Valuta në të cilën kryhet transaksioni
Amt=	Shuma e transaksionit	N	var. deri në 12	UTF-8 Std		M	M		<ul style="list-style-type: none"> • Shuma e transaksionit do të jetë e ndryshme nga zero, do të përfshijë vetëm shifrat (numerike) "0" deri në "9" dhe mund të përmbajë një "." karakter si shenjë dhjetore. • Kur shuma përfshin numra decimal, "." karakteri do të përdoret për të ndarë numrat decimal nga vlera e numrit të plotë dhe "." karakteri mund të jetë i pranishëm edhe nëse nuk ka decimale. • Numri i shifrave pas shenjës decimale është 2 shifra. • Format i vetëm i pranuar i shumës është formati i përshkruar më lartë. Ai nuk mund të përmbajë asnjë karakter tjetër (për shembull, asnjë karakter hapësirë ose presje nuk mund të përdoret për t'i ndarë mijëra). Shembull: 12.3 euro • (vetëm për QR kodin vendas). Nëse vlera është 0, aplikacioni celular duhet të nxisë konsumatorin të fusë shumën e transaksionit.

Cty=	Qyteti	ans	var. deri në 15	UTF-8 Std		0	0	<ul style="list-style-type: none"> • Obligative për C2B dhe B2B • Qyteti i përfituesit/paguesit është qyteti i vendndodhjes fizike të përfituesit/paguesit.
Bil=	Numri i faturës	ans	var. deri në 25	UTF-8 Std		0	0	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i faturës ose numri i faturës për mallrat dhe/ose shërbimet e ofruara për konsumatorin. Mund të përdoret për të identifikuar një transaksion specifik. • Ky numër mund të sigurohet nga tregtari (dhe kështu është i pranishëm kur gjenerohet QR kodi) ose mund të përdoret si një tregues për aplikacionin e pajisjes telefonike për të nxitur konsumatorin të fusë një numër fature.
Stl=	Etiketa e dyqanit	an	var. deri në 25	UTF-8 Std		0	0	<ul style="list-style-type: none"> • Një vlerë dalluese e lidhur me një dyqan. Kjo vlerë mund të sigurohet nga paguesi ose i paguari ose mund të jetë një tregues që aplikacioni i pajisjes telefonike ta shtyjë konsumatorin të fusë një etiketë dyqani.
Tid=	ID e terminalit	ans	var. deri në 25	UTF-8 Std		0	0	<ul style="list-style-type: none"> • Një vlerë unike e lidhur me një terminal në dyqan. Për shembull, etiketa e terminalit mund t'i shfaqet paguesit ose të paguarit në aplikacionin e pajisjes telefonike duke identifikuar një terminal specifik ose përdoret për zgjidhjen e mashtrimit.
Ptn=	ID e taksës së të paguarit	ans	10	UTF-8 Std		0	0	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i identifikimit tatimor të përfituesit/tregtarit, i caktuar nga juridiksioni i organit qeveritar.

Uid=	Utility ID	ans	var. deri në 25	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i ofruesve të shërbimeve të alokuara nga Banka Qendrore
Cid=	ID e klientit	ans	var. deri në 25	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Numri identifikues i klientit Përdoret për Pagesat e faturave
Qid=	Numri unik i sekuencës së QR	ans	8	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Numri unik i sekuencës siç caktohet nga lëshuesi i ngarkesës së pagesës QR
Dtt=	Data dhe koha e QR kodit	N	var. deri në 29	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Data dhe ora kur u krijua kodit QR. Formati i orës UTC YYYY-MM-DDThh:mm:ss.sssZ ose UTC me zhvendosje YYYY-MM-DDThh:mm:ss.sss+/-hh:mm Shembull 2022-02-14T15:29:17.615+01:00
Adr=	Adresa	an	var. deri në 70	UTF-8 EXT		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Adresa e paguesit ose të paguarit
Pnm=	Emri i paguesit	ans	var. deri në 70	UTF-8 EXT		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Emri i paguesit
Pac=	Llogaria e paguesit	ans	var. deri në 34	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Llogaria e paguesit
Sec=	Tokeni i sigurisë së QR kodit	ans	var. deri në 64	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Hash kriptografik i sigurisë i llogaritur në të dhënat e QR kodit
Lyn=	Numri i besnikërisë	ans	var. deri në 25	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Numri i besnikërisë së klientit
Prc=	Kodi i provizionit	n	2	UTF-8 Std		0	0		<ul style="list-style-type: none"> Kodi i provizionit

Ord=	Numri serik i faturës	ans	var. deri në 4	UTF-8 Std		o	o		• Numri serik i faturës
Cr=	Kodi Enu	ans	10	UTF-8 Std		o	o		• Pajisja elektronike e arkës – Pajisja elektronike e parave të gatshme, pajisje fiskale për lëshimin e faturave të parave të gatshme
Sw=	Softveri	ans	10	UTF-8 Std		o	o		• Kodi i softuerit të instaluar në ENU
Pdt=	Data e pagesës	ans	var. deri në 20	UTF-8 Std		o	o		• Data në formatin dd.mm.yyyy hh:mm:ss
Sft=	Kodi I Swift-it	ans	8	UTF-8 Std		o	o		• Kodi I Swift-it
Cbn=	Emri i bankës së kredituesit	ans	var. deri në 70	UTF-8 EXT		o	o		• Emri i bankës së kredituesit
Qic=	Kontrolli i integritetit të QR	ans	8	UTF-8 Std		o	o		• Kur është prezent, është fusha e fundit • Shuma kontrolluese (checksum) e llogaritur mbi të gjithë objektin e të dhënave të përfshirë në QR kodit • Algoritmi i përdorur varësisht nga skenari.

2

Table 2: Lista e objekteve të të dhënave për kodin QR i rastit paguesi prezent

ID e fushës	Emri i objektit të të dhënave	Formati	Gjatësia	Seti i Karaktereve	QR kodit përmbanë	Vlera	Përshkrimi dhe rregullat
					Tokeni		
PAYLOAD							
Pid=	ID e emetuesit të ngarkesës së pagesës së QR kodit (ang. QR Payload Issuer ID)	an	3	UTF-8 Std	O		<ul style="list-style-type: none"> • Identifikohet pala e cila e gjeneron QR kodin. • Nuk kërkohet nëse është i njëjtë me ofruesin e Shërbimit MCT
Tkn=	Tokeni	an	var. deri në 300	UTF-8 Std	M		<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa është që ai të jetë unik dhe të mund të përdoret për të marrë të dhënat e transaksionit. Tokeni tregon për: <ul style="list-style-type: none"> • Emri i Mbajtësit të Llogarisë • Emri tregtar i të paguarit • IBAN/ID e llogarisë • Kodi i kategorisë së të paguarit • Lloji i instrumentit të pagesës • Qëllimi i transferimit të kreditit / Lloji i pagesës • Informacioni i remitançave • Valuta e transaksionit • Shuma e transaksionit • Çdo fushë tjetër sipas rastit të përdorimit
TBD	TBD	an	var. deri në 70	UTF-8 Std	O		<ul style="list-style-type: none"> • Tekst i pastër. Fusha që do të përcaktohet në varësi të Rastit të Përdorimit

8

1.3.4. Shembujt e ngarkesës së pagesës

1.3.4.1. Shembuj të përbërjes së një QR kodi për përdorim ndërkombëtar:

Shembulli i URL për QR kodin i paguari prezent (Payee presented QR Code) me Token:
[/HTTPS://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Tken=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833](https://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Tken=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833)

Shembulli i URL për QR kodin paguesi prezent (Payer presented QR Code) me Token:
[/HTTPS://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Tken=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833](https://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Tken=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833)

1.3.4.2. Shembuj të përbërjes së një QR kodi për përdorim kombëtar:

Shembulli i URL për Kodi QR i paguari prezent (Payee presented QR Code) në tekst të pastër:
[/HTTPS://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/Pmt=1&Pid=123&Anm=Telkom company
Pty&Tnm=Telkom&Ibn=XK051212012345678906&Pcc=1234&Pit=ACH&Ppt=1234&Rmt=1234567890&Cur=EUR&Amt=12.3](https://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/Pmt=1&Pid=123&Anm=Telkom%20company%20Pty&Tnm=Telkom&Ibn=XK051212012345678906&Pcc=1234&Pit=ACH&Ppt=1234&Rmt=1234567890&Cur=EUR&Amt=12.3)

Shembulli i URL për QR kodin i paguari prezent (Payee presented QR Code) për proksi:
[/HTTPS://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Pmt=2&Pid=123&Pxt=1&Prx=00383521003760&Pcc=1234&Pit=ACH&Ppt=1234&Rmt=1234567890&Cur=EUR&Amt=12.3](https://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Pmt=2&Pid=123&Pxt=1&Prx=00383521003760&Pcc=1234&Pit=ACH&Ppt=1234&Rmt=1234567890&Cur=EUR&Amt=12.3)

Shembulli i URL për QR kodin i paguari prezent (Payee presented QR Code) me token:
[/HTTPS://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/Pmt=3&Pid=123&Tkn=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833](https://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/Pmt=3&Pid=123&Tkn=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833)

Shembulli i URL për QR kodin paguesi prezent (Payer presented QR Code) me token:
[/HTTPS://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Pid=123&Tkn=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833](https://xyz.qrc.bqk-kos.org/1/i/123/?Pid=123&Tkn=Czs7sckkvBpJls4yq9n31j3jeKqNN833)

Shtojca 2

Diagramet dhe rrjedha e pagesës




Figura 1: Diagrami standard i QR kodit




Figura 2: Ekosistemi i akterëve të QR kodit në Kosovë për Kodin QR i biznesit/tregtarit prezent




Figura 3: Ekosistemi i akterëve të QR kodit në Kosovë për QR kodin i konsumatorit prezent




Figura 4: Kodi QR statik me paraqitjen e të paguarit dhe rrjedha e pagesës

Hapi	Përshkrimi
1	Tregtari shfaq një kod QR statik me detaje të tregtarit që përfshin numrin identifikues të pjesëmarrësit të kreditorit (ang. Creditor Participant identification number), emrin e tregtarit dhe numrin e llogarisë.
2	Konsumatori skanon kodin QR duke përdorur një aplikacion nga pajisja telefonike
3	Aplikacioni nga pajisja telefonike deshifron kodin QR, shfaq transaksionin duke përfshirë detajet e tregtarit dhe e kërkon që konsumatori të fusë shumën e transaksionit.
4	Konsumatori verifikon detajet e transaksionit, fut shumën dhe autorizon pagesën.
5	Aplikacioni nga pajisja telefonike fillon pagesën duke dërguar kërkesën për fillimin e pagesës tek pjesëmarrësi debitor.
6	Pjesëmarrësi debitor vërteton mesazhin dhe kontrollon që paguesi ka fonde të mjaftueshme dhe gjeneron transferin e kreditit
7	Pjesëmarrësi debitor e dorëzon transferin e kreditit në FPS të BQK-së për përpunim dhe kliring
8	FPS-ja e BQK-së njofton pjesëmarrësit debitor dhe kreditor për përpunimin e suksesshëm të transferimit të kreditit dhe llogaritë e Konsumatorit dhe Tregtarit debitohen dhe kreditohen respektivisht
9	Pjesëmarrësi Debitor njofton paguesin se pagesa është përpunuar me sukses dhe pjesëmarrësi Kreditor njofton Tregtarin që fondet janë pranuar

R




Figura 5: Kodi QR dinamik me paraqitje e të paguarit dhe rrjedha e pagësës

Hapi	Përshkrimi
1	Tregtari gjeneron dhe shfaq një kod QR me informacionin e tregtarit dhe transaksionit
2	Konsumatori skanon kodin QR duke përdorur një aplikacion nga pajisja telefonike
3	Aplikacion nga pajisja telefonike deshifron kodin QR, shfaq transaksionin duke përfshirë detajet e tregtarit dhe shumën e transaksionit të Konsumatori
4	Konsumatori verifikon detajet e transaksionit dhe autorizon pagesën
5	Aplikacioni nga pajisja telefonike fillon pagesën duke dërguar kërkesën për fillimin e pagesës tek pjesëmarrësi debitor i konsumatorit
6	Pjesëmarrësi debitor vërteton mesazhin dhe kontrollon që paguesi ka fonde të mjaftueshme dhe gjeneron transferin e kreditit
7	Pjesëmarrësi debitor e dorëzon transferin e kreditit në FPS të BQK-së për përpunim dhe kliring
8	Pasi transferta e kreditit të jetë përpunuar dhe kliringu është kryer nga FPS, Debitori dhe Pjesëmarrësit Kreditorë njoftohen për rezultatin e transferimit të kreditit
9	Pjesëmarrësi Debitor njofton paguesin se pagesa është përpunuar me sukses dhe pjesëmarrësi Kreditor njofton Tregtarin që fondet janë pranuar